**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA PUKË**
**DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE**

**Nr.23005 prot.** **Pukë, më 16. 12. 2022**

**P R O J E K T - V E N D I M**

**Nr. 13 Datë 16 . 12 .2022**

# PËR DHËNIE TITULLI QYTETAR NDERI I BASHKISË PUKË

**Z. Bardh Doda**

Këshilli i Bashkisë Pukë në zbatim të nenit 54, pika "m" të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; të nenit 3, pika 1; nenit 14, pika 1; nenit 15, pika 1/a dhe 2; nenit 16, pika 1; nenit 17; nenit 18; nenit 19; nenit 20, pika "ç"; të ligjit nr. 112/2013 "Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; të nenit 113, pika "dh", të ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, me Propozim të Kryetarit të Bashkisë ,

**V E N D O S I :**

1. T'i jepet titulli "Qytetar Nderi" i Bashkisë Pukë, **z. Bardh Doda** me motivacionin:

**"Për kontributin e çmuar si mësues dhe drejtues në fushën e arsimit e të kulturës . I përkushtuar në realizimin e reformave shtetërore që i përkasin pushtetit vendor si dhe menaxhues i aftë në përballimin e situatave emergjente brenda dhe jashtë komunitetit pukjanë."**

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55 pika 6, i ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".

Drejtor DMBNJ
Emirjona Pergjegjaj

Jurist
Aida Sinani

**K R Y E T A R I**
**Gjon Gjonaj**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA PUKË

Adresa: Bashkia Pukë, sheshi "Gjergj Kastrioti (Skenderbeu)", e-mail: bashkiapuke@yahoo.com, faqe zyrtare www.bashkiapukë.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

**Nr. 2309/1 prot.** **Pukë, më 16.12.2022**

**Relacion**

**PËR MIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR DHËNIE TITULLI "QYTETAR NDERI"**

**Z. Bardh Doda**

Mbështetur në ligjin nr. **139/2015** "Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin **112/2013,** "Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendore të nderit në Republiken e Shqipërisë", (ndryshuar me ligjin nr. **10/2015**, datë **19.2.2015**), pas vlerësimit të kërkesës së bërë për dhënien e titullit qytetar nderi **z. Bardh Doda** me qëllim që të vlerësohet puna dhe kontributi i tij , Këshilli i Bashkisë duke konsideruar propozimin , ju propozon anëtarëve të Këshillit Bashkiak që të vlerësohet figura e tij dhe personaliteti, duke ju dhënë titulli i nderit në shenjë respekti dhe mirënjohjeje publike për të gjithë kontributin dhe përkushtimin e tij në fushën e arsimit . I lindur me datë 10.08.1952 në Berishë të Epërme , Qyqesh. Vazhdoi studimet në vitet 1972-1975 , në Shkodër. E filloi karrieren e tij si mësues histori - gjeografie në vitin 1975-1979 në shkollen e mësme të bashkuar Iballe. Nga 1979 deri 1986 ka punuar si drejtor prane shkolles 8-vjeçare në Berishë të Vogël dhe nga 1986-1992 drejtor i shkollës së mesme të bashkuar Iballe. Karriera e tij ka kaluar në shumë etapa dhe vende pune të ndryshme si nënkryetar i këshillit të rrethit në Pukë , po ashtu në 2003-2005 nënprefekt në qytetin e Pukës etj . Vlerave të tij profesionale i ka dëshmuar duke shërbyer në çdo kohë dhe vend për bashkëqytetarët e tij.

Me propozim të Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore:

T'i jepet titulli "Qytetar Nderi" i Bashkisë Pukë, **z. Bardh Doda** me motivacionin:

**"Për kontributin e çmuar si mësues dhe drejtues në fushën e arsimit e të kulturës . I përkushtuar në realizimin e reformave shtetërore që i përkasin pushtetit vendor si dhe menaxhues i aftë në përballimin e situatave emergjente brenda dhe jashtë komunitetit pukjanë."**

Ky titull i jepet në shenjë nderimi dhe vleresimi për të gjithë punën dhe kontributin e dhënë në fushën e arsimit, **z. Bardh Doda.**

1. Për të gjitha meritat e lartpërmendura propozohet t'i akordohet titulli "Qytetar Nderi i Bashkise Pukë".

**Drejtor Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore**
**Emirjona Pergjegjaj**

Adresa: Bashkia Pukë, sheshi "Gjergj Kastrioti (Skenderbeu)", e-mail; bashkiapuke@yahoo.com, faqe zyrtare www.bashkiapukë.gov.al

Puke me.30.11.2022

**Lenda**: Propozim per dhenje titull qytetar nderi i Bashkis Puke,Z.Bardh Llesh Doda.

**KESHILLIT BASHKIAK**

**PUKE**

Me ane te te ciles propozojme Keshillit Bashkiak dhenjen e titullit "**Qytetar Nderi**"**i Bashkise Puke Z. Bardh Doda me motivacionin "Per kontributin e qmuar si mesues dhe drejtues ne fushen e arsimit e te kultures,i perkushtuar ne realizimin e reformave shteterore qe i perkasin pushtetit vendor,menagjues i afte ne perballimin e situatave emergjente Brenda dhe jasht komunitetit pukjan."**

Z.Bardh Doda shquhet per kontributet e tij ne fushen e arsimi,.si ne mesim dhenje por dhe si drejtues ,si dhe ne menagjimin e situates se krijuar ne vitin 1999,gjate luftes ne kosove duke punuar me perkushtim per stabilizimin e vellezerve tane kosovar, te larguar nga kosova ne periudhen e luftes.

Mendojme se vlersimi i nje figure te tille si Z.Bardh Doda i ben nder jo vetem keshillit bashkiak,por dhe mbre komunitetit pukjan.

Bashkngjitur cv e Z.Bardh Doda.

**Grupi nismetar**

| Kr/Kshillit | Keshilltar | Keshilltar | Keshilltare |
|---|---|---|---|
| Enver Sulejmani | Arben Guga | Dritan Asani | Agetina Guga |

KRYETARI

Gjon GJONAJ

## (no subject)

1 message

**anjeza doda** <dodaanaanjeza@gmail.com>
To: "alpaskuale@gmail.com" <alpaskuale@gmail.com>

Wed, Aug 17, 2022 at 11:15 AM

Bibliografi
Origjina dhe ngjarje
Vendbanimi i hershem, guri i deskut, katundi i kishes, mahalla desk, berishe e vogel. Shperngulur nga guri i deskut ne qyqesh ne vitin 1850, kryefamiljar palush gjoni. Qyqeshi ka qene vend per stane te gurit te deskut. Territori i mbuluar me lajthi ku ne pranvere degjohej kenga e qyqeve. Qyqesh nga ana e klimes shpjegohet : qyqe per dimer e qesh per vere.
Nga e zogjve vend ku kendonin qyqet ne lajthi. Qyqeshi nga tradita e fisit sebashku me milorin e qafes se mugut njihen dy porta te fuqishme te mbrojtjes se fisit . Qyqeshi ne lindje dhe milori ne perendim. Ngjarje te rendesishme te familjes ne vite.
1. Ne vitin 1911 Ndrec Hasani ( Llesh Ndrec Hasani) ka percjelle Hasan Prishtinen nga shtepia e tij ne boset (breblla) tek Vat Martini , meqenese kishte qendruar ne shtepine ne shtepine e tij nje nate.
Hasan Prishtina ne vitet 1910- 1912 ka levizur shume ne itinerarin gjakove - shkoder duke kaluar dhe takuar berishasit per kryengritje te medha . Sa here qe Hasan Prishtina donte te hynte berishe dera e shtepise toe ne qyqesh ishte e hapur per te dhe per bashkepunetoret e tij
Ne vitet1923- 1924 perkatesisht ne revolucionin e qershorit duke ju pergjigjur thirrjes se Bajram Currit per revolucion dy axhet e mi Nikoll Ndreca dhe Zef Ndreca me arme ne dorejane rreshtuar me kryengritesit e veriut nen drejtimin e Rexhep Shalesper rrezimin e qeverise se Ahmet Zogut.
Me kthimin e Ahmet Zogut ne pushtet ne 1925 dy axhet jane denuar me burg per tre vite ne Elbasan. Kane thyer burgun dhe kane dale pas nje viti.
Me ardhjen e brigades 6 sulmuese ne Iballe per fshatin berishe e eper axha im Zef Ndreca eshte zgjedhur ne drejtimin e keshillit nacionalclirimtar. Kurse nena ime Drande Prendieshte zgjedhur kryetare e gruas.
Bardh Llesh Doda
Ditelindja 10.08.1952 , vendlindja berishe e eper qyqesh , baba Llesh Ndrec Hasani qyqesh, nana Drane Prend Pjetri nga bugjoni e deres shtepise se bajraktarit te thacit. Nana e babes Shkurte Baftinja fshati mzi, nana e nanes Dile Lulja fshati porav .
Bardh Doda: Shkolla fillore berishe e eper 1959 - 1962
shkolla 8-vjecare puke 1963 - 1967
shkolla e mesme puke 1967- 1971
shkolla e larte shkoder 1972- 1975
Karriera ne pune
1975- 1979 mesues histori - gjeografi ne shkollen e mesme te bashkuar Iballe
1979 - 1986 drejtor i shkolles 8 vjecare berishe e vogel
1986 - 1992 drejtor i shkolles se mesme te bashkuar iballe
Si drejtues ne vitin 1988 kam organizuar dhe festuar 85 vjetorin e shkolles se pare shqipe ne iballe. Me keto evenimene , sesion shkencor per kohen kur u hap shkolla e pare shqipe ne iballe, ndertimi i ri i muzeut te arsimit per shkollen ne iballe ne vite, ndertimi i terrenit sportiv te shkolles, eshte botuar broshure per kremtimin e 85 vjetorit te shkolles,
1992 - 1996 Keshilli i rrethit ne puke me detyre nenkryetar.
gjate kesaj kohe kam drejtuar me sukses te plote dy detyra kryesore te qeverise shqiptare,ndarja e tokes ne gjithe rretin sipas ligji 5701 pa asnje incident, privatizimi i banesave shteterore ne gjithe rrethin.
Vitet 1996 - 2000 sekretar i bashkise puke
Mars - qershor 1999 kryetar i komisionit per menaxhimin e shtetasve kosovare ne bashkine puke, detyre e realizuar me perkushtim te larte
2000 - 2002 drejtor ne konviktin e shkolles se mesme puke
2003- 2005 nenprefekt i pukes ne prefekturen shkoder
Ne kete periudhe mbetet per tu vecuar situata e jashtezakonshme e janar 2005 qe u menaxhua ne te gjithe rrethin pa asnje demtim njerezor
2005 - 2007 mesues ne shkollen e mesme puke
2007 - 2017 mesues dhe zv/drejtor ne shkollen e mesme te bashkuar 8 Dhjetori Qelez
1.10.2017 e ne vazhdim pensionist
Aksione kombetare
ndertimi i hekurudhes rrogozhine lushnje dy here klase e nente dhe e dhjete
ndertimin e hekurudhes elbasan perrenjas klase e 11 dhe 12
Veprimtari partiake
Delegat, anetar i PS ne kongresin themelues 10 - 12 qershor 1991
anetar kryesie komiteti nga vitet 1992 - 2012
kryetar i OS 1 bashkia puke 2002- 2017 pa asnje humbje elektorale ne zgjedhje

Ne oren 13 mbi 300 vete u turren ne oborrin e shkolles , une me disa mesues isha ne shkolle, dola perpara turmes dhe fillova te komunikoj me ta, por e pamundur . mu kujtuan dy gjera menjehere, une ju thashe : seshte llogjike qe njerezit e shkolles e iballes te djegin prape shkollen ( histori 1903). nese mendoni se e kam vjedhur shkollen kontrollojeni ate. 4 a 5 persona u futen ne shkolle , kontrollun gjendjen dhe ne dalje i komunikuan turmes , ketu seshte prekur asgje . keshtu shpetoi shkolla , isha i lumtur qe ne vitin 1992 shpetuam pa u djegur shkollen e pare shqipe.
2 ) mars 1997 isha ne zyren e kryetarit te bashkise puke na informuan se persona nga komuniteti mysliman po i vene zjarrin kishes , menjehere vepruam. direkt kryetari Halit Furriku shkoi tek Kisha dhe sebashku me qytetaret e lidhur perdore rrethuan Kishen dhe nuk lejuan qe ajo te prekej. Me te njejtin model veprova edhe une duke mbrojtur xhamine. Veprimet tona parandaluan nje perplasje midis dy besimeve , gje qe enderronin huliganet. Veprimin tone e pershendeten gjithe qytetaret pa dallim , sebashku me banoret e komunave rrape, gjegjan , qelez.
3 ) Mars 1997 isha ne zyre rreth ores 13 i gjithe qyteti gjemonte nga krismat e kallashnikove , njerez te armatosur me pamje te frikshme leviznin ne qytet duke qelluar papushim, qytetaret te alarmuar vraponin duke u fshehur . shpejt morem vesh se keta kriminele te armatosur kishin dale nga burgu. Keshtu u realizua hapja e burgut , imagjinoni i gjithe qyteti ne duart e krimininele ve . Kjo eshte dita me tmerrshme qe kam perjetuar.

Me respekt
Bardh Doda